

## **KLSH PËR NDARJEN ADMINISTRATIVE**

*nga Bedri ÇOKU,*

*botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 27 Shkurt 2014 dhe në gazetën “Ekonomia”, më 28 shkurt 2014.*

Një nga institucionet kushtetuese ndër të parët që ka dhënë kumtin për rëndësinë e kryerjes në mënyrë efikase të reformës së ndarjes së re administrative të vendit, ka qenë Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), qysh në nëntor 2013, me përfundimin e auditimit të performancës për ndarjen e tanishme territoriale. Në këtë auditim të performancës KLSH gjeti se Qarqet nuk kanë një informacion mbi gjendjen ekonomike, numrin e popullsisë, të ardhurat që marrin nga taksat, tatimet, nga njësitë vendore përkatëse (bashkitë dhe komunat). Në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, nuk janë përcaktuar qartë funksionet e qarqeve dhe si rrjedhojë, bashkitë dhe komunat nuk raportojnë rregullisht, pasi kjo nuk është e përcaktuar në ligj. Mungesa e stafit të kualifikuar i çon qarqet në informacione jo të drejta për vendim-marrjet e rëndësishme. KLSH ka rekomanduar që të shikohet mundësia e një studimi për ndarjen territoriale administrative tokësore, në drejtim të riorganizimit të qarqeve në rajone, duke zënë kështu vendin që duhet. Numri i popullsisë për rajon të jetë jo më pak se 700.000 banorë dhe vijat ndarëse të tyre të jenë bazenet e lumenjve.

Gjithashtu, nga krahasimi i zonave rurale me ato urbane, KLSH vuri re se të parat janë më ineffiçente në realizimin e investimeve, veçanërsht tek ato më të varfrat. Duket qartë se decentralizimi nuk ka qenë i suksesshëm, pasi ato kërkojnë mbështetje nga pushteti qëndror për të vazhduar veprimtarinë e tyre. Një situatë e këtillë tregon qartë diferencat që ekzistojnë ndaj komunave e bashkive, zbutja e të cilave kërkon një efiçencë të madhe administrimi të brendshëm, e cila nuk është arritur në asnjë komunë apo bashki me numër të vogël popullsie. KLSH rekomandoi që të studiohet mundësia e bashkimit të bashkive dhe komunave. Kur ato janë me numër popullsie të vogël, të bashkohen me njëra – tjetrën, duke marrë për bazë pozitën gjeografike, fqinjësinë e mirë dhe në përputhje me kulturën, traditën e

interesat ekonomiko – sociale, me pikësynim rritjen e efijencës në realizimin e investimeve, duke zbatuar funksione e veta. KLSH kerkoj po ashtu të shikohet mundësia e bashkimit të komunave dhe bashkive, te cilat, pavaresisht nga popullsia, kanë gjendje ekonomiko financiare jo të mjaftueshme për kryerjen e investimeve në realizimin e funksioneve të veta, me qëllim rritjen e kapaciteteve administrative dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore për krijimin e të ardhurave të veta. Në këtë proces, duhet të merret në konsideratë bashkëpunimi dhe mendimi me ekspertët e fushës, me OJF-të, etj.

Në auditimin e tij, KLSH vuri re se diferencat që ka krijuar situata aktuale e ndarjes administrative-territoriale, ka ndihmuar vetëm komunat dhe bashkitë, të cilat janë me numër më të madh popullsie, në zhvillimin e tyre ekonomik. Kjo ka sjell dhe rritjen e të ardhurave të veta. Nga ana tjetër në komunat dhe bashkitë e vogla, ku popullsia është larguar, situata financiare është përkeqësuar, duke shkaktuar ngadalësimin e zhvillimit ekonomik dhe social, si dhe vartësinë e tyre tek Buxheti i Shtetit.

Serisht, KLSH rekomandoi me forcë që të bëhet një studim efikas, duke e orientuar ndarjen administrative – territoriale drejt bashkimit të komunave dhe bashkive të vogla dhe inefijente, me qëllim rritjen e besueshmërisë për përthithjen e projekteve, rritjen e efijencës, dhe krijimin e mundësisë së huamarrjes nga bashkive e komunat, me qëllim financimin e shpenzimeve kapitale që shërbejnë për zhvillimin zonal, gjë që krijon mundësira dhe lehtësira për zhvillimin e bizneseve të vogla.

Sot është koha që kush punon për rishikimin e ligjit dhe kryerjen e reformës administrative, të degjojë rekomandimet e KLSH dhe të lexojë me kujdes raportin e auditimit të performances për ndarjen teritoriale.

KLSH sygjeron që praktika më e mirë për bashkimin e bashkive dhe komunave të vogla është ajo e arritjes së këtij qëllimi, duke u mbështetur te bashkimi me baza vullnetare. Ndryshimi në ndarjen administrative që sjell bashkim apo ndarje të njësive vendore prek drejtpërdrejtë interesat e banorëve. Kjo nxjerr në pah domosdoshmërinë e gjetjes së konsensusit me banorët. Për këtë duhet marrë mendimi i banorëve, nëpërmjet organeve të zgjedhura apo në forma të tjera konsultimi, deri, po ta dojë nevoja për tërheqjen e mendimit, edhe me referendum vendor. Ndarja e re administrativo-territoriale duhet të organizohet me, ose pa ndryshim kufijsh ekzistues të njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me interesat ekonomike e sociale, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlera të

tjera vendore, për realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore, ose për zbatimin e politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe më gjerë.

Ky proces ka vështirësi, pasi mund të shkaktojë konflikte të karakterit të pronësisë, apo të përdorimit të burimeve ujore, pyjeve, kullotave etj., midis fshatrave të ndryshëm të cilat mund të marrin përmasa më të mëdha, kur bashkimi(ndarja e re territoriale) nuk i trajton me kujdes dhe në kohën e duhur.

Ndarja e re administrative -territoriale ka një interes të lartë publik dhe impakt social. Mungesa e investimeve të disa njësive të qeverisjes vendore ka sjellë moszhvillim ekonomik-social të zonave të ndryshme të vendit. Nga ana tjetër, një reformë e suksesshme e ndarjes administrative territoriale është parakusht për integrimin dhe thithjen e fondeve nga BE. Ajo gjithashtu ndihmon në realizimin dhe përmbushjen e misionit të Kartës Europiane për Autonominë Vendore.